

FËMIJËT NUK KANË NEVOJË TË NJOHIN DHUNËN



ABUZIMI I FËMIJËVE



Maltretimi i fëmijës përfshin të gjitha llojet e abuzimit dhe mospërfilljes së fëmijës nën moshën 18 vjeçare nga prindi, kujdestari apo ndonjë person tjetër në rolin e kujdestarit (p.sh. trajneri, mësimdhënësi).

Ekzistojnë katër lloje të rëndomta të abuzimit:

Abuzimi fizik është përdorimi i forcës së qëllimshme fizike, si goditja, shkelmimi, tundja, djegia apo ndonjë shfaqje tjetër e forcës kundër fëmijës.

Abuzimi emocional u referohet sjelljeve që e dëmtojnë vlerën apo mirëqenien emocionale të fëmijës. Këtu përfshihen sharjet, turpërimi, refuzimi, ndalimi i dashurisë dhe kërcënimi.

Mospërfillja është dështimi për t'i përmbushur nevojat themelore të fëmijës. Në këto nevoja përfshihen strehimi, ushqimi, veshmbathja,

arsimimi dhe qasja në kujdes shëndetësor.

Abuzimi seksual përfshin angazhimin e fëmijës në akte seksuale. Këtu përfshihen përkëdhelja, dhunimi dhe ekspozimi i fëmijës ndaj aktiviteteve të tjera seksuale.

Prindërit dhe kujdestarët e tjerë janë shkelësit më të shpeshtë të tri kategorive të para të abuzimit të fëmijës. Përveç kësaj, ka pasur disa raporte në Kosovë për abuzim fizik dhe seksual të fëmijëve nga mësimdhënësit e tyre. Sikur dhuna në familje, dhuna fizike ndaj fëmijëve nga prindërit, kujdestarët dhe mësimdhënësit e tyre është konsideruar tradicionalisht e pranueshme dhe brenda fushës së masave edukative të fëmijës. Për shkak të faktit që Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka përfshirë parimet e të drejtave të fëmijës të mbrojtura me Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, gjithnjë e më tepër fëmijë janë në dijeni që dhuna nuk duhet të tolerohet.

Statistikat ndërkombëtare mbi abuzimin e fëmijës

- 40 milionë fëmijë janë subjekt i abuzimit të fëmijës çdo vit.
- Vetëvrasja është shkaktari i tretë kryesor i vdekjes ndër adoleshentë në mbarë botën.
- Rreth 20% e femrave dhe 5-10% e meshkujve raportojnë se janë abuzuar si fëmijë, ndërsa 25-50% e të gjithë fëmijëve raportojnë se abuzohen fizikisht.
- Statistikat tregojnë se 3 milionë vajza të reja janë subjekt i gjymtimit seksual çdo vit.

PUNA E FËMIJËVE



Puna e fëmijës është njëra prej formave kryesore të përdorimit të fëmijës për qëllime të fitimit. Ajo shpesh kombinohet me forma të tjera të shkeljes së të drejtave të fëmijës, si trafikimi, shfrytëzimi seksual, abuzimi dhe, në disa raste, edhe shfrytëzimi i fëmijëve për shpërndarje të drogës.

Puna e fëmijës është e pranishme në zonat urbane dhe rurale. Shpesh ndodh që fëmijët në shoqëritë tona punojnë për t'i mbajtur familjet e veta: duke shitur gjësende në rrugë, duke kërkuar lëmoshë, duke pastruar xhama të veturave, etj. Fëmijët që punojnë bëhen më të cenueshëm ndaj abuzimeve të tjera. Këta fëmijë zakonisht janë të familjeve të varfra dhe shpesh të familjeve që janë shpërngulur nga zonat e vogla apo rurale. Fëmijët tregojnë shenja të mospërfilljes nga familjet e tyre dhe kjo lehtë mund të shfrytëzohet nga kriminelët. Puna e bën fëmijën të pambrojtur pasi ai u ekspozohet formave të ndryshme të abuzimit në familje dhe jashtë saj dhe ndaj përjashtimit shoqëror.

TRAFIKIMI



Fëmijët dhe të rinjtë janë viktimat më të shpeshta të trafikimit. Trafikimi për seks është njëra prej formave më të shpeshta të trafikimit të fëmijëve dhe të të rinjve.

Pasojat e trafikimit për seks

Fëmijët që bëhen viktimat të trafikimit shpesh vuajnë nga abuzimi shumë i madh fizik dhe/ose seksual. Fëmijët e trafikuar shpesh përfundojnë në rreth vicioz të dëshpërimit, varësisë dhe ri-trafikimit. Për këto arsye, viktimat fëmijë të trafikimit mund ta humbin shpresën e tyre dhe të bien në depresion që shpesh shpie edhe në përpjekje për vetëvrasje. Ata vuajnë pasoja negative afatgjata në shëndetin e tyre.

Ata mund të shpërfillen nga familjet dhe komunitetet e veta

nëse ndodh të kthehen në shtëpi. Ata mund të përfshihen në aktivitete kriminale. Disa fëmijë (ish-viktima të trafikimit apo të tjerë) mund të rekrutohen për t'u bërë pjesë e rrjetit për abuzim të fëmijëve të tjerë ose mund të përfundojnë duke krijuar sistemin e vet të shfrytëzimit të fëmijëve dhe, si rrjedhojë, edhe vetë përfundojnë në rrethin e abuzuesve të dhunshëm.

Fëmijët shpesh tregojnë simptoma të ndërlikuara lidhur me përvojat e tyre traumatike. Sa më i gjatë që të jetë abuzimi, problemet e tyre shëndetësore do të jenë më të mëdha. Fëmijët viktimat të trafikimit për seks mund të vuajnë nga sëmundje të ndryshme veneriane, AIDS-i, shtatzënitë e padëshiruara, infertiliteti, etj.

Shumë fëmijë të trafikuar i ekspozohen edhe abuzimit të drogës. Atyre u jepet drogë për t'i mbajtur pasivë në mënyrë që të mund t'i përdorin ose për ta mbajtur varësinë e tyre nga furnizuesit e drogës në mënyrë që t'u shmangen përpjekjeve të tyre për t'i lënë abuzuesit e tyre.

PËRDORIMI I DROGËS DHE VARËSIA



Cilat janë periudhat me rrezik më të lartë për abuzim të drogës ndër të rinjtë?

Hulumtimi ka treguar se periudhat kryesore të rrezikut për abuzim të drogës paraqiten gjatë ndryshimeve të mëdha në jetën e fëmijëve. Këto ndryshime përfshijnë ndërrime të mëdha në zhvillimin fizik (p.sh. pubertetin) ose situatat sociale (si shpërngulja ose shkurorëzimi i prindërve) kur fëmijët përjetojnë cënueshmëri të shtuar për sjellje problematike. Ndryshimi i parë i madh për fëmijë është në adoleshencën e

hershme – kur fëmijët ka të ngjarë të ndeshen me abuzim të drogës për herë të parë. Më pas, kur të shkojnë në shkollë të mesme, fëmijët e rinj ballafaqohen me sfida të tjera sociale, psikologjike dhe arsimore. Në të njëjtën kohë, ata mund t'i ekspozohen mundësisë më të madhe të sigurimit të drogës, abuzuesve të drogës dhe angazhimeve shoqërore ku përfshihet droga. Këto sfida mund ta rrisin rrezikun se ata do të abuzojnë me alkool, duhan dhe droga të tjera.

Në familje

Fëmijët ka më tepër të ngjarë të përjetojnë rrezik nëse:

- kanë mungesë ose përkujdesje joefikase të prindërve,
- kanë mjedis kaotik në familje,
- kanë mungesë të lidhjes familjare me një të rritur që kujdeset për ta,
- një prind ose kujdestar që përdor substanca vuan nga sëmundje mendore ose angazhohet në sjellje kriminale.

Këto përvoja, posaçërisht abuzimi i drogës dhe i substancave të tjera nga prindërit ose kujdestarët, mund ta pengojnë lidhjen me familje dhe t'i kërcënojnë ndjenjat e sigurisë që fëmijëve u nevojiten për zhvillim të shëndoshë.

Jashtë familjes

Faktorë të tjerë të rrezikut lidhen me cilësinë e raporteve të fëmijëve në mjediset jashtë familjes, si në shkollë, me shokë të tyre, mësimdhënësit dhe në komunitet. Vështirësitë në këto mjedise mund të jenë vendimtare për zhvillimin emocional, mendor dhe shoqëror të fëmijës. Disa prej këtyre faktorëve të rrezikut janë:

- sjellja e pavend në klasë, si agresiviteti dhe impulsiviteti,
- dështimi në shkollë,
- shkathtësitë e dobëta të ballafaqimit shoqëror,
- shoqërimi me shokë që kanë sjellje problematike, përfshirë abuzimin e drogës, dhe
- perceptimi i gabuar i përmasës dhe pranueshmërisë së sjelljeve të abuzimit të drogës në shkollë, me shokë dhe në mjedise të komunitetit.

Shoqërimi me shokë që abuzojnë drogën është shpesh rreziku më i drejtpërdrejtë për t'i ekspozuar adoleshentët ndaj abuzimit të drogës dhe sjelljes delikvente. Faktorë të tjerë – si mundësia e sigurimit të drogës, mënyrat e trafikimit të drogës dhe besimet që abuzimi i drogës në përgjithësi tolerohet – janë gjithashtu rreziqe që mund të ndikojnë në të rinjtë për të filluar me abuzim të drogës.

Disa shenja të rrezikut mund të shihen që në fillim. Tiparet e personalitetit ose temperamentit të fëmijëve mund t'i vejnë ata në rrezik të shtuar për abuzim të mëvonshëm të drogës. Djemtë e tërhequr dhe agresivë, p.sh., shpesh shfaqin sjellje problematike në ndërveprim me familjet e tyre, shokët e tyre dhe me të tjerë me të cilët takohen në mjedise shoqërore. Nëse këto sjellje vazhdojnë, ato ka të ngjarë të shpijnë në rreziqe të tjera. Studimet kanë treguar se fëmijët me sukses të dobët në shkollë dhe sjellje të pavend shoqërore në moshën 7 deri në 9 vjeçare ka më tepër të ngjarë të përfshihen në abuzim të substancave nga mosha 14 ose 15 vjeçare.



DHUNA E TË RINJVE

Dhuna e të rinjve definohet si “përdorim i qëllimshëm i forcës ose fuqisë fizike, të kërcënuar apo aktuale, kundër një personi tjetër ose kundër një grupi apo komuniteti që rezulton ose ka gjasa të mëdha të rezultojë në lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, zhvillim të keq ose privim.

Në Dhuna e të rinjve, synimi për të përdorur forcë nuk do të thotë doemos synim për të shkaktuar dëm. Në fakt, në shumë raste ka dallim të madh mes sjelljes së synuar dhe pasojës së synuar. P.sh., një i ri mund të përfshihet në një përleshje fizike me një të ri tjetër më tepër me qëllim

të ngacmimit ose frikësimit, por kjo mund të rezultojë në lëndim të rëndë trupor që nuk ishte menduar.

Dhuna mund të jetë publike ose private, kriminale ose jokriminale, reaguese (si përgjigje ndaj ndodhive të mëparshme, si provokimi) apo proaktive. Është me rëndësi të dihen shkaqet e dhunës dhe të mendohet për hartimin e programeve për parandalim.

Faktorët e rrezikut

Hulumtimi i lidh këta faktorë të rrezikut me ushtrimin e dhunës:

Faktorët e rrezikut individual	Faktorët e rrezikut në familje
<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e vëmendjes, hiperaktiviteti ose çrregullimet në mësimnxënie• Historia e sjelljes agresive të hershme• Përfshirja në droga, alkool apo duhan• Koeficienti i ulët i inteligjencës• Mungesa në aftësitë shoqërore për njohje apo procedim të informatave• Shqetësimi i lartë emocional• Qëndrime antishoqërore• Ekspozimi ndaj dhunës dhe konfliktit në familje	<ul style="list-style-type: none">• Qëndrime autoritare në edukimin e fëmijëve• Praktika të ashpra ose jokonsistente disiplinore• Përfshirja e ulët e prindërve• Lidhja e ulët emocionale me prindër apo ofrues të kujdesit• Edukimi i ulët nga prindërit dhe të ardhura të ulëta• Abuzimi i substancave apo kriminaliteti nga prindërit• Funkcionimi i dobët i familjes• Monitorimi dhe mbikëqyrja e dobët e fëmijëve
Shokët dhe faktorët e rrezikut në shoqëri	Faktorët e rrezikut në komunitet
<ul style="list-style-type: none">• Shoqërimi me shokë delikente• Përfshirja në grupe• Refuzimi shoqëror nga kolegët• Mungesa e përfshirjes në aktivitete të rinisë• Suksesi i dobët në shkollë• Angazhimi i ulët në shkollë dhe dështimi në shkollë	<ul style="list-style-type: none">• Mundësi të pakta ekonomike• Përqendrime të larta të banorëve të varfër• Nivele të ulëta të pjesëmarrjes në komunitet• Lagje të çrregulluara në marrëdhënie shoqërore

DHUNA NË SHKOLLË

Çka është dhuna në shkollë?

Dhuna në shkollë është një nëngrup i dhunës së të rinjve. Dhuna është përdorim i qëllimshëm i forcës apo fuqisë fizike kundër një personi, grupi apo komuniteti tjetër me sjellje që ka të ngjarë të shkaktojë dëmtim fizik apo psikologjik.

Në shembuj të sjelljes së dhunshme përfshihen:

- Ngacmimi
- Përleshja (p.sh., grushtimi, flakaresha, shkelmimi)
- Përdorimi i armëve
- Sulmi elektronik
- Dhuna e grupeve

Dhuna në shkollë ndodh:

- Në pronë të shkollës
- Rrugës për në shkollë ose duke u kthyer nga shkolla
- Gjatë ndonjë ndodhie të sponsorizuar nga shkolla
- Rrugës për në ndonjë ndodhi të sponsorizuar nga shkolla ose duke u kthyer nga ndonjë ndodhi e sponsorizuar nga shkolla.



ARMËT NË SHKOLLA

Arma paraqet kërcënim serioz për fëmijët dhe të rinjtë e Kosovës pasi ata gjithnjë e më tepër kanë qasje më të madhe në thika dhe pistoletë. Ato barten brenda në shkollë dhe, përkundër faktit që shumë shkolla tani janë të pajisura me kamera, është shumë vështirë të zbulohen ato armë pa detektorë për metal në shkolla. Posedimi i armëve të tilla

në shkolla e rrit mundësinë për lëndime të rënda trupore dhe vrasje në shkolla. Kemi qenë dëshmitarë në 2-3 vjetët e fundit të një rritjeje të madhe të dhunës me armë në shkolla në mbarë Kosovën, që, për fat të keq, shpesh kanë përfunduar me fatalitet. Ekziston nevoja për përpjekje më të koordinuara mes prindërve, menaxhmentit të shkollës dhe autoriteteve të tjera për ta parandaluar këtë lloj të dukurisë negative. Prindërit luajnë rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e posedimit të armëve nga fëmijët e tyre dhe e parandalojnë dëmin ndaj tyre dhe të tjerëve. Shumë shpesh, armët përdoren vetëm pse janë në dispozicion të nxënësve, e jo sepse ata synonin t'i përdornin ato dhe të shkaktonin dëm. Parandalimi i dëmit të padëshiruar ndaj nxënësve është detyra më e rëndësishme e shoqërisë sonë. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të dinë, nga njëra anë, që posedimi i çfarëdo lloji të armës (qoftë ajo thikë, pistoletë apo diç tjetër) është vepër penale dhe se përdorimi i saj është vepër edhe më e rëndë penale që shpie në burgosje. Shkollat, nga ana tjetër, duhet të kenë politikë të "tolerancës zero" ndaj posedimit të armëve në shkolla dhe të sigurojnë që nxënësit janë në dijeni për pasojat/sanksionet e posedimit të tillë.



NGACMIMI

Ngacmimi është një lloj i dhunës së të rinjve që kërcënon mirëqenien e të rinjve. Ai mund të rezultojë në lëndime fizike, vështirësi shoqërore dhe emocionale, dhe probleme shkollore. Efektet e dëmshme të ngacmimit shpesh ndihen nga të tjerët, përfshirë shokët dhe familjet, dhe mund ta lëndojnë shëndetin e përgjithshëm dhe sigurinë në shkolla, lagje dhe shoqëri.

Ngacmimi mund të jetë në forma të ndryshme, por zakonisht përfshin këto lloje të sjelljes:

- Fizike: goditje, shkelmim, pickim, grushtim, gërvishtje, pështymje apo ndonjë formë tjetër e sulmit fizik;
- Dëmtimi ose marrja e sendeve personale të dikujt tjetër;
- Verbale: sharja, fyerja, bërja e shakave raciste, seksiste apo homofobiste, vërejtjet apo bezdisjet, përdorimi i gjuhës sugjestive apo abuzive, vërejtjet ofenduese;
- Indirekte: përhapja e storjeve të ndyra për dikë, përjashtimi nga grupet shoqërore, bërja subjekt i thashethemeve keqdashëse, dërgimi i postës, emailave dhe tekst porosive abuzive (ngacmimi kibernetik).

NGACMIMI ELEKTRONIK/ NGACMIMET PERMES INTERNETIT

Duket që teknologjia dhe të rinjtë janë të destinuara për njëri-tjetrin. Të dytë janë të rinj, shkojnë me hapa të shpejtë dhe ndërrojnë prorre. Teknologjia është zhvilluar shumë në dy dekadat e fundit dhe është përvetësuar shumë shpejt nga të rinjtë. Teknologjia e re u sjell të rinjve përfitime të shumta. Teknologjia e re gjithashtu ofron mundësi për lidhje shpërblyese shoqërore për ata të rinj që kanë vështirësi për ta zhvilluar miqësinë e tyre në mjedise tradicionale shoqërore ose për shkak të kontakteve të kufizuara me moshatarët e tyre. Përveç kësaj, qasja e rregullt në internet u mundëson adoleshentëve dhe grup-moshave më të reja që shpejt ta rrisin njohurinë e tyre për një gamë të gjerë të temave.

Megjithatë, zhvillimi i vrullshëm në teknologji nuk vjen pa rreziqe të mundshme. Të rinjtë i përdorin mediet elektronike për t'i turpëruar, ngacmuar apo kërcënuar shokët e tyre. Një numër gjithnjë e më i madh i adoleshentëve janë duke u bërë viktimat e kësaj forme të re të dhunës – sulmit elektronik apo ngacmimit përmes internetit.



Ngacmimi përmes internetit është cilido lloj i ngacmimit që kryhet përmes mjeteve elektronike. Ekzistojnë shtatë lloje të ngacmimit përmes internetit, përfshirë:

- Ngacmimin përmes tekst porosive;
- Fotografitë/videoklipet përmes kamerave të telefonave mobilë;
- Ngacmimin përmes thirrjeve telefonike;
- Ngacmimin përmes emailave
- Ngacmimin në dhoma të bisedimit (chat-room);
- Ngacmimin përmes porosive të menjëhershme;
- Ngacmimin përmes uebsajteve.

Sikur format tradicionale të dhunës së të rinjve, edhe sulmi elektronik lidhet me shqetësimin emocional dhe problemet e sjelljes në shkollë.

Dhuna vdekjeprurëse në shkolla që lidhet me ngacmimin

Statistikat e ngacmimit në mbarë botën tregojnë që hakmarrja është motivimi më i fortë për të shtëna me armë, goditje me thikë dhe sulme në shkolla. Kur fëmijët fillojnë të njihen me të

tjerët, të bëjnë shaka apo t'i ngacmojnë, kjo i bën adoleshentët të bëhen vdekjeprurës dhe të dhunshëm. Kur fëmijët kanë qenë viktimat të abuzimit fizik ose kur kanë qenë dëshmitarë të abuzimit fizik në shtëpi, kjo mund të shpjerë në dhunë në shkollë.

Ngacmimi dhe vetëvrasja

Një hulumtim i kryer nga Yale School of Medicine [Fakulteti i Mjekësisë i Jejlit], duke u bazuar në studime nga 13 vende, gjeti shenja të një lidhjeje të dukshme mes ngacmimit, të qenët i ngacmuar dhe vetëvrasjes. I njëjti studim ka treguar se viktimat e ngacmimit ka më tepër të ngjarë që 2-9 herë ta shqyrtojnë vetëvrasjen.

Vetëvrasja që lidhet me ngacmimin mund të jetë e lidhur me cilindo lloj të ngacmimit, përfshirë:

- Ngacmimin fizik
- Ngacmimin emocional
- Ngacmimin kibernetik
- Dërgimin e fotove seksuale apo qarkullimin e fotove sugjestive apo lakuriqe ose të teksteve për një person.

Nga studimi i kryer me 225 nxënës të klasave 6-9 në shkollat e Kosovës në zonat rurale, një numër i konsiderueshëm i tyre kanë raportuar se janë ngacmuar përmes internetit ose telefonit nga nxënës të tjerë dhe këtë duke:

- I imituar ata në internet,
- Postuar materialet e tyre personale, ose
- Shkruar tekst porosi.

Një numër i vogël i tyre pranoi t'i kishte ngacmuar të tjerët në internet.

Faktorët mbrojtës për të gjitha llojet e dhunës së të rinjve dhe ngacmimit

Faktorët mbrojtës i frenojnë të rinjtë nga rreziqet e të bërit i dhunshëm. Identifikimi dhe kuptimi i faktorëve mbrojtës është po aq i rëndësishëm sa edhe hulumtimi i faktorëve të rrezikut. Dhuna e të rinjve është problem serioz që mund të ketë efekte të dëmshme afatgjata në viktimat dhe familje të tyre, shokë dhe komunitete. Qëllimi për parandalimin e dhunës së të rinjve është i thjeshtë—pikësëpari të ndalet dhuna e të rinjve që të mos ndodhë.

Përpjekjet për parandalim duhet të synojnë t'i pakësojnë faktorët që i vejnë të rinjtë në rrezik. Parandalimi duhet t'i trajtojë të gjitha llojet e ndikimeve mbi dhunën e të rinjve: individuale, të raporteve, të komunitetit dhe të shoqërisë. Strategjitë e parandalimit efikas nevojiten për ta ngritur vetëdijesimin për dhunën e të rinjve dhe për ta nxitur angazhimin për ndryshime shoqërore.

Studimet propozojnë këta faktorë mbrojtës:

Faktorët mbrojtës individualë	Shokët dhe faktorët mbrojtës shoqërorë
<ul style="list-style-type: none"> • Qëndrim jotolerant ndaj shmangies • Koeficient i lartë i inteligjencës • Mesatare e lartë e notave • Orientim pozitiv shoqëror • Shkathtësi tejet të zhvilluara shoqërore 	<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi në shkollë • Marrëdhënie të ngushta me shokë jo-devijues • Përfshirja në aktivitete pro-shoqërore • Ekspozimi në mjedise të mira në shkollë
Faktorët mbrojtës në familje	Faktorët mbrojtës në shkollë
<ul style="list-style-type: none"> • Lidhja me familje apo të rritur jashtë familjes • Mundësia për t'i diskutuar problemet me prindër • Pritjet e perceptuara të prindërve për sukses në shkollë janë të larta • Aktivitete të shpeshta të ndara me prindër • Përfshirja në aktivitete shoqërore • Përdorim i strategjive konstruktive në familje për t'u ballafaquar me probleme • Angazhimi i familjes me shkolla dhe prindër të tjerë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i mbikëqyrjes së nxënësve • Përdorimi i rregullave të shkollës dhe i teknikave për menaxhim të sjelljes në klasë dhe në shkollë për ta zbuluar dhe trajtuar dhunën dhe ngacmimin në shkollë duke i sqaruar pasojat e saj • Të pasurit e një politike kundër dhunës dhe ngacmimit në tërë shkollën dhe zbatimi i përhershëm i asaj politike • Përkrahja e bashkëpunimit mes personelit të shkollës, prindërve dhe profesionistëve të ndryshëm

RREZIQET NGA RRJETET SOCIALE

Rrjetet e ndryshme sociale si Facebook, Twitter, LinkedIn, etj. janë bërë pjesë e jetës sonë të përditshme për komunikim me njëri-tjetrin. Por rrjetet sociale gjithashtu janë duke u përdorur për abuzim seksual me fëmijë dhe të rinj. Përdorimi i rrjeteve sociale i ka disa të meta:

- Zhytesh aq shumë në rrjete sociale sa që ndjen se nuk mund të jetosh pa jetën në internet. Kjo mund të krijojë varësi të rrezikshme. Në këtë mënyrë, ti i lejon gjërat që vërtet kanë rëndësi për ty të kalojnë pa i shijuar.
- Mund të zhytesh aq shumë në rrjete sociale sa që nuk do të gjesh kohë për t'u takuar personalisht me shokët tu ose edhe më keq, me të afërmit tu.
- E meta më e madhe e medieve sociale është se ato ua lënë derën të hapur shumë kriminelëve të rrezikshëm të cilët i gjejnë viktimat e tyre përmes këtyre rrjeteve.



Në bazë të ligjëratave të mbajtura me nxënës të klasave 6-9 në disa zona rurale të Kosovës, rezultoi që prindërit kanë fare pak apo më mirë të themi nuk kanë fare kontroll apo njohuri se cilin uebsajt janë duke e shfletuar fëmijët e tyre. Ka mungesë të njohurisë nga prindërit dhe fëmijët për sigurinë në internet dhe rreziqet e mundshme nga interneti.

Prej 229 fëmijëve të anketuar në këto shkolla rezultoi që:

- 90% kalojnë së paku 1- 3 orë në ditë në internet
- 95% përdorin rrjete të ndryshme sociale në të njëjtën kohë:
 - o 98% Facebook-un
 - o 50% Twitter-in
 - o 40% media të tjera sociale.
- 38% e postojnë në rrjete sociale adresën e tyre të shtëpisë.
- 32% postojnë në rrjete sociale informata për shkollën në të cilën i ndjekin mësimet.
- 45% kanë pranuar kërkesa për “miqësim” nga të huajt.
- Kërkesat nga këta të huaj ishin të ndryshme, si:
 - o 20% kanë kërkuar prej tyre takim;
 - o 33% kanë kërkuar foto të tyre personale;
 - o 31% kanë kërkuar adresën apo numrin e tyre të telefonit;
 - o 16% kërkesa të tjera, si pyetje për jetën private, kërkesa për lidhje miqësore, etj.

Në vijim janë disa rregulla që mund t’u ndihmojnë të rinjve, e posaçërisht fëmijëve që të qëndrojnë të sigurt në internet:

- 1. Mos i dërgo informata personale asnjë personi që nuk e ke takuar personalisht.** Këtu përfshihet emri i shkollës tënde, i anëtarëve të familjes tënde dhe adresa jote! Kurrë nuk e di kush në të vërtetë fshihet pas atij personi.
 - pa marrë parasysh çka të thonë në internet apo si duken në foto! Të gjitha mund të jenë të rreme. Kriminelët janë vazhdimisht në lëvizje në mënyrë që të mos zihen.
- 2. Kurrë mos posto në internet dhe mos i dërgo shokut tënd foto gjysmëlakuriq apo lakuriq.**
- 3. Mos u përfshij në diskutime jopërkatese në tema rreth seksit kur je në internet, madje edhe kur je duke e bërë këtë vetëm.** Për ta bërë këtë më të qartë – KURRË asgjë nuk mbetet sekrete në internet.
- 4. Kurrë mos u pajto të takohesh me dikë që nuk e njeh – posaçërisht jo vetëm.** Nëse dikush të thotë, “Mos u trego prindërve tu,” ose “Askush nuk duhet ta dijë,” – zakonisht diçka fshihet prapa kësaj dhe në veçanti nëse je fëmijë këtë duhet t’ia tregosh një të rrituri, prindërve apo dikujt që i beson dhe e njeh.
- 5. Duhet të kesh parasysh që kriminelët në internet i njohin me përpikëri mendjet e vajzave të reja.** Ata do të përpiqen në çdo mënyrë të marrin atë që dëshirojnë nga ti. Si rezultat, kjo mund të shpjerë në kidnapim, dhunim dhe përvoja të tjera të tmerrshme. Kriminelët i bëjnë këto sende vazhdimisht në internet dhe mbase këtë e kanë bërë edhe më parë me vajza të tjera.

Dhe pjesa e keqe është që:

“Ai djalosh i ri, i pashëm dhe i ëmbël që e ke takuar në internet do të dalë se nuk është 18 por 50 vjeçar.”

Mëso ta kontrollosh përdorimin e rrjeteve sociale dhe mos i lejo rrjetet sociale ta kontrollojnë jetën tënde.

Sugjerime për prindër

Bisedoni me fëmijën tuaj	Hulumtojeni internetin
<ul style="list-style-type: none">• Prindërit dhe kujdestarët shpesh i pyesin fëmijët ku po shkojnë dhe me kë po shkojnë kur dalin nga shtëpia.• Duhet ta bëni të njëjtën pyetje edhe kur fëmija juaj kyçet në internet.• Fëmijët ngurrojnë ta zbulojnë viktimizimin për shkak të frikës se do t'u hiqen privilegjet për internet dhe telefon.• Zhvilloni zgjidhje për ta parandaluar apo trajtuar viktimizimin që nuk e dënojnë fëmijën.	<ul style="list-style-type: none">• Vizitoni uebsajtet që fëmija juaj i viziton shpesh dhe vlerësoni pro dhe kundër. Mos harroni, shumica e uebsajteve u ndihmojnë të rinjve të mësojnë dhe të lidhen me njerëz me interesa të ngjashme.• Informohuni për pajisjet dhe uebsajtet e reja që fëmija juaj është duke i përdorur.• Vazhdimisht bisedoni me fëmijën tuaj lidhur me “ku janë duke shkuar” dhe hulumtojeni edhe vetë teknologjinë.• Ndalimi i të rinjve për të pasur qasje në mediet elektronike mund të mos jetë zgjidhje e mirë afatgjate.
Zhvilloni rregulla	Bashkëpunimi me shkolla
<p>Së bashku me fëmijën tuaj, zhvilloni rregulla për sjellje të pranueshme e të sigurta për të gjitha mediet elektronike. Rregullat duhet të përqendrohen në mënyrat për t'i shtuar në maksimum përfitimet e teknologjisë dhe për t'i ulur rreziqet e saj.</p>	<p>Prindërit dhe kujdestarët duhet të bashkëpunojnë me shkolla në zhvillimin e një qasjeje bashkëpunuese për t'i parandaluar të gjitha llojet e dhunës në shkollë dhe për ta rritur vetëdijesimin mbi rreziqet nga mediet sociale.</p>

Material vetëdijësues pregatitur me qëllim të vetëdijësimit të fëmijëve dhe të rinjëve mbi llojet e ndryshme të dhunës që ata mund të ekspozohen si viktimë apo edhe kryes dhe rreziqet që rrjedhin nga ato.

**Pregatitur nga,
Benina Kusari dhe
Eliza Thana
Departamenti Amerikan i Drejtësisë
Ambasada Amerikane Prishtinë**



